

# MARËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT

---

## DORACAK INFORMUES

MBI RREGULLAT E PËRFITIMIT TË PREFERENCAVE TATIMORE  
SIPAS RREGULLAVE TË ORIGJINËS

**MSA**  
**MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT**

---

**HYRJE**

---

Procesi i Stabilizim Asociimit për Ballkanin Perëndimor, është politikë kyçe e BE-së për Ballkanin Perëndimor, me qëllim të anëtarësimit të tij në BE. Procesi është lansuar në qershor 1999 dhe rikonfirmuar në Samitin e Selanikut, në qershor 2003.

Kosova ka qenë pjesë e procesit integruar të Ballkanit Perëndimor, qysh nga viti 2002, kur ka filluar procesi i Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim Asociimi. Në vitin 2009, ky proces është avancuar në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit.

Sidoqoftë, asnjëri nga këto dy mekanizma nuk kanë qenë instrumentet zyrtare të Bashkimit Evropian për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. BE-ja, për shkak 5 vendeve që nuk e njohin Pavarësinë e Kosovës, nuk ka qenë në gjendje t'i ofrojë Kosovës, proces të njëjtë anëtarësimi sikurse për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ky proces për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor ka filluar me lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). MSA-ja përfaqëson marrëveshjen më të rëndësime ligjore dhe politike, e cila është themel i procesit të anëtarësimit në BE.

Në vitin 2012, BE ka vendosur të përgatit Studimin e Fizibilitetit për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Studimi konfirmoi se Kosova është kryesisht e gatshme të fillojë negociatat për MSA. Për të filluar negociatat, Kosova duhet të përmbushë 4 kritere shtesë në sundimin e ligjit, tregti, reformën e administratës publike dhe mbrojtjen e minoriteteve.

Në prill 2013, Komisioni Evropian konkludoi se Kosova i përmbushi 4 kriteret dhe, rrjedhimisht në korrik 2013, Këshilli dha dritën e gjelbër për nisjen e negociatave për MSA.

Procesi negociator ka filluar më 28 tetor 2013 dhe, rrjedhimisht janë mbajtur 3 takime në nivel të Kryenegociatorëve dhe dhjetëra takime të grupeve teknike. Procesi negociator u përmbyll më 2 maj 2014.

Më 25 korrik 2014 Marrëveshja është inicializuar, ndërsa më 22 tetor 2015 MSA u miratua në Këshillin e BE-së.

*Nënskërimi i MSA-së u bë më 27 tetor 2015 në Strasburg. Kuvendi i Republikës së Kosovës, ratifikoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimi, më 2 nëntor 2015.*

---

## PËRMBATJA

---

1. Çka është MSA	4
2. Rëndësia ekonomike e MSA-së	5
3. Rregullat e origjinës	6
4. Përfitimi i origjinës preferenciale	7
5. Kumulimi i origjinës	8
6. Procedurat për përcaktimin e origjinës preferenciale të mallrave në Republikën e Kosovës	9
7. Dokumentet që vërtetojnë origjinën e produktit	10
8. Mundësia e kumulimit të origjinës në kontestin e MSA-së e ndërlidhur me marrëveshjen CEFTA	11
9. Tarifat doganore në MSA për produktet nga kapitujt 24-97	15
10. Tarifat doganore në MSA për produktet nga kapitujt 01-24	18
11. Konventa regjionale PEM – sistemi i akumulimit	20

---

## ÇKA ËSHTE MSA

---

MSA është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënieve formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve, me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE.

Nëpërmjet MSA themelohet një Asociacion ndërmjet Kosovës dhe BE, i cili ka për qëllim që vendit tonë t'i ofrohet:

1. Përkrahje për përforcimin të demokracisë dhe sundimit të ligjit.
2. Përkrahje për stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional, si dhe stabilizimin e rajonit.
3. Kornizë e përshtatshme për dialogun politik që do të mundësojë zhvillimin e marrëdhënieve të afërta politike ndërmjet palëve.
4. Përkrahje në zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, nëse rrethanat objektive lejojnë, që edhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së.
5. Përkrahje për kompletimin e transicionit në ekonomi funksionale të tregut.
6. Përkrahje në promovimin e marrëdhënieve të mirëfillta ekonomike dhe zhvillim gradual të tregut të përbashkët ndërmjet vendit tonë dhe BE-së
7. Përkrahje në përforcimin e bashkëpunimit rajonal në të gjitha fushat që mbulohen nga MSA.

---

## RËNDËSIA EKONOMIKE E MSA-së

---

1. Zhvillimi gradual i zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Kosovës dhe BE-së brenda 10 viteve.
2. Liberalizimi gradual i tregut të Kosovës për produktet e BE-së.
3. Qasja e plotë e produkteve të Kosovës në BE.
4. Qasje e bizneseve kosovare në një treg prej mbi 500 milionë banorësh.
5. Qasje e qytetarëve në një gamë më të madhe të produkteve dhe shërbimeve më të mira dhe me çmime më të lira.
6. Zhvillimi, revitalizimi dhe modernizimi i ekonomisë drejt përfundimit të tranzicionit në ekonominë funksionale të tregut.
7. Përafrimi i legjislacionit në fushën e ekonomisë.
8. Përforsimi i sundimit të ligjit në fushën e ekonomisë.
9. Përafrimi i politikave ekonomike me ato të Unionit Monetar dhe Ekonomik.
10. Krijimi i institucioneve ekonomike të reja dhe përforsimi i institucioneve ekonomike ekzistuese.
11. Përmirësimi i mjedisit afarist.
12. Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve përmes qasjes në asistencë financiare dhe teknike të ofruar nga BE dhe nëpërmjet bashkëpunimit në pranimin më të shpejtë të know-how dhe në qasjen në teknologji të reja.
13. Bashkëpunim në hulumtime dhe zhvillim teknologjik.
14. Përkrahje në përforsimin e sektorit bankar të sigurimeve dhe të shërbimeve financiare.
15. Rritja e investimeve të huaja direkt.
16. Rritja e investimeve vendore.
17. Rritja e konkurrencës dhe stimulimi i eksportit.
18. Përafrimi i legjislacionit në fushën e punësimit.
19. Përkrahje në arritjen e standardit adekuat të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në përputhje me Procesin dhe Deklaratën e Bolonjës.
20. Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe materiale të qytetarëve.
21. Krijimi i vendeve të reja të punës.
22. Përkrahje për stabilitet makroekonomik në rast nevojë nëpërmjet asistencës financiare në formë të granteve dhe kredive.

*Nga viti 2000, Kosova ka përfituar nga Masat Autonome Tregtare të BE-së, të cilat kanë mundësuar eksportin e të gjitha produkteve të Kosovës në BE. Sidoqoftë, këto masa kanë qenë njëanshëm dhe kanë mundur të ndryshohen në çfarëdo momenti.*

---

## RREGULLAT E ORIGJINËS

---

Me qëllim të zbatimit të MSA-së, do të aplikohen Shtojca I dhe dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale, mbi rregullat preferenciale Pan-Euro-Mediterrane të origjinës - Konventa Rajonale (PEM).

Të gjitha referencat për "marrëveshjen përkatëse" në Shtojcën I të Konventës Rajonale dhe në dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale, do të interpretohen siç parashihet në këtë Marrëveshje

### Neni 1

1. Kjo Konventë përmban dispozita mbi origjinën e mallrave të tregtuara sipas marrëveshjeve përkatëse të përfunduara ndërmjet palëve kontraktuese.

2. Koncepti i "produkteve të origjinës" dhe metoda e bashkëpunimit administrativ në lidhje me to, janë përcaktuar në shtojcat e kësaj Konvente.

Shtojca I përcakton rregulla të përgjithshme për konceptin e produkteve të origjinës dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

Shtojca II përcakton rregulla të veçanta të zbatueshme ndërmjet palëve të caktuara kontraktuese dhe që devijojnë nga dispozitat e parashikuara në shtojcën I.

3. Palët e mëposhtme janë kontraktuese në këtë Konventë:

- Bashkimi Evropian;
- Shtetet e EFTA-s siç renditen në preambul;
- Ishujt Faroe;
- Pjesëmarrësit në Procesin e Barcelonës, siç renditen në preambul;
- Pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, siç renditen në preambul.

Në lidhje me Bashkimin Evropian, kjo Konventë zbatohet në territorin në të cilin është i zbatueshëm Traktati i Bashkimit Evropian, sipas përkufizimit në nenin 52 të atij traktati dhe nenin 355 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian.

---

## PËRFITIMI I ORIGJINËS PREFERENCIALE

---

Për qëllimet e zbatimit të Marrëveshje, produktet e mëposhtme konsiderohen të kenë origjinën nga një palë kontraktuese, nëse eksportohen nga në një palë tjetër kontraktuese:

- a) produktet e përfuara tërësisht në palën kontraktuese brenda kuptimit të nenit 4;
- b) produktet e përfuara në palën kontraktuese, duke përfshirë materiale që nuk janë përfuara plotësisht atje, me kusht që këto materiale t'u jenë nënshtruar punës ose përpunimit të mjaftueshëm në atë palë kontraktuese brenda kuptimit të nenit 5;

---

## KUMULLIMI I ORIGJINËS

---

Në lidhje me aplikimin e Kumulimit Diagonal të Origjinës, para se gjithash, duhet të plotësohen Tri Kushtet:

- a. MTL ndërmjet të gjithë partnerëve (palëve);
- b. Aplikimi i rregullave identike të Origjinës; dhe
- c. Publikimi në Matricë i datave relevante për aplikim në Gazetën Zyrtare të BE-së, Seria C në web site:

[http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52016XC0220\(02\)&from=EN](http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52016XC0220(02)&from=EN)

Pa paragjykuar parashikimet e (nenit 2 të KONVENTËS PEM), produktet do të konsiderohen si origjinuese në një palë, nëse produkte të tilla janë siguruar atje, duke përfshirë materiale origjinuese të palës tjetër në përputhje me parashikimet e këtij protokoll, duke siguruar që punimi ose përpunimi i zbatuar te pala do të shkojë përtej operacioneve referuar nenit 6 . Nuk do të jetë e nevojshme, që të tilla materiale të kalojnë një punim apo përpunim të mjaftueshëm.

Pa paragjykuar parashikimet e të njëjtit Nen, produktet do të konsiderohen si origjinuese në Komunitet ose në çdo palë tjetër pjesëmarrëse, ose që ka lidhje me procesin e Stabilizim Asociimit (këtej e tutje referuar si "Palë PSA"), nëse produkte të tilla janë përfuara atje, materialet origjinuese të përfshira në ndonjë palë PSA tjetër ose në Komunitetin Evropian, me kusht që punimi ose përpunimi të zbatohen në palën PSA të shkojë përtej operacioneve referuar nenit 6. Nuk do të jetë e nevojshme që të tilla materiale të kalojnë një punim ose përpunim të mjaftueshëm.

Në tabelën e më poshtme janë të pasqyruara datat e zbatimit të protokolleve mbi rregullat e origjinës, të cilat protokolle mundësojnë zbatimin e Kumulimit diagonal:

	EU	AL	BA	MK	ME	MO	RS	KS
EU		01.01.2007	01.07.2008	01.01.2007	01.01.2008	01.11.2015	08.12.2009	01.04.2016
AL	01.01.2007		22.11.2007	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	24.10.2007	26.07.2007
BA	01.07.2008	22.11.2007		22.11.2007	22.11.200	26.07.2007	22.11.2007	26.07.2007
MK	01.01.2007	26.07.2007	22.11.2007		26.07.2007	26.07.2007	24.10.2007	26.07.2007
ME	01.01.2008	26.07.2007	22.11.2007	26.07.2007		26.07.2007	24.10.2007	26.07.2007
MO	01.11.2015	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007		24.10.2007	26.07.2007
RS	08.12.2009	24.10.2007	22.11.2007	24.10.2007	24.10.2007	26.07.2007		26.07.2007
KS	01.04.2016	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	26.07.2007	

1. Në zonën e tregtisë së lirë CEFTA 2006, bazuar në njoftimin të ri nga Komisioni Evropian, datë 22.02.2016, në të cilin njoftim janë të përfshira Kosova dhe Moldavia , përkrah Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnjë Hercegovinës dhe Serbisë, për të cilat Konventa ka hyrë në fuqi në përputhje me datat e treguara në tabelën e bashkëngjitur me këtë akt.

Në përputhje me Shtojcën I (definimin e termit "produkte origjinuese" dhe metodat e bashkëpunimit administrativ), Konventa do të zbatohet në kuadrin e CEFTA 2006:

- Produktet që rrjedhin nga zbatimimi i nenit 3 të Aneksit I të Konventës ndërmjet Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnjë Hercegovinës, Moldavisë dhe Serbisë (kumulimit me materialet me origjinë të vendeve të përmendura;
- Produktet që janë tërësisht të përfituara në Kosove, Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni, Bosnjë Hercegovinë, Moldavia dhe Serbi;
- Produktet me origjinë preferenciale Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnjë Hercegovina, Moldavia dhe Serbia, të cilët janë punuar apo përpunuar mjaftueshëm me materiale origjinuese të vendeve përmendura më lartë;
- Produktet me origjinë preferenciale nga Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnjë Hercegovina, Moldavia dhe Serbia, që vërtetojnë origjinën e tyre në tregtinë e ndërsjellë ndërmjet tyre në përputhje me Konventën.

Për qëllimet e zbatimit të këtij Protokollit të Origjinës konform Konventës PEM dhe në përputhje me njoftimi i ri nga Komisioni Evropian, në tregtinë ndërmjet vendeve do të përdoret certifikata mbi qarkullimin e lirë të mallrave EUR.1, Seria A, e cila nuk përmban shënimin në seksionin 7 "Kumulimi i aplikuar me" ose "jo Kumulimi ", apo deklarata e origjinës, e cila nuk përmban shënimin "kumulimi aplikuar me" ose "jo Kumulimi ".

2. Në zonën e tregtisë së lirë e cila përfshin vendet: EU, Kosovën, Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë, mund të zbatohet Kumulimi diagonal në procesin e Stabilizim Asociimit (këtej e tutje referuar si "Palë PSA").
3. Po ashtu, vendi zbaton Sistemin Autonom të Preferencave me; EU, CH, NO, Turqi SHBA etj., në harmoni me rregullat e origjinës të përcaktuara në këto Sisteme, të cilat veçse i kemi në zbatim.



---

**PROCEDURA PËR PËRCAKTIMIN E ORIGJINËS PREFERENCIAL TË MALLRAVE NË  
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

---

Si rezultat i procedurës së përcaktimit të origjinës së produkteve që eksportohen nga Republika e Kosovës në Bashkimin Evropian, situatat e mëposhtme janë të mundshme:

- a) produkti është me origjinë të Kosovës; dhe
- b) produkti është me origjinë e njërit nga "partnerët".
  - a) Në përputhje me dispozitat e Protokollit, produktet që eksportohen nga Republika e Kosovës në Bashkimin Evropian, mund të ketë origjinë Kosovare, nëse:
    - 1) janë tërësisht të përfituara (Neni 4 i Shtojcës I);
    - 2) Të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm (Neni 5 i Shtojcës I), d.m.th. plotëson kushtet e përcaktuara në Listën e operacioneve të përpunimit (SHËNIMET HYRËSE PËR LISTËN E ANEKSIT II), ku:
      - 2.1) punimet apo përpunimet të kryera në Kosovë, janë më të larta se sa punimi apo përpunimi i pamjaftueshëm ("proceset minimale"), e përmendur në Nenin 6. në shtojcën I Protokollit III; ose
      - 2.2) në Kosovë janë kryer vetëm veprimet që konsiderohen si punime apo përpunime të pamjaftueshme ("proceset minimale"), të listuara në Nenin 6. të shtojcën I.

- b) Produkti është me origjinë e një nga "partnerët";

Në përputhje me dispozitat e Protokollit, nëse eksportet nga Republika e Kosovës në Bashkimin Evropian, atëherë produktet mund të kenë origjinë e njërit nga "partnerët" nëse:

- 1) produkti me origjinë në një nga "partnerët", në të cilën produkt në Kosovë, nuk është bërë asnjë trajtim ose përpunim, atëherë ato produkte ruajnë origjinën e tyre, nëse eksportohen në një prej palëve të tjera kontraktuese (neni 3, paragrafi 4 i shtojcën I); ose
- 2) produkti nuk plotëson kushtet e përcaktuara në Listën e operacioneve të përpunimit (Aneksi II i Protokollit), ku operacioni i kryer në produktin në Kosovë, nuk i tejkalon operacionet punimit apo përpunimit, gjegjësisht ("operacionet minimale"), të përmendura në nenin 6. të shtojcës I Protokollit III ) ose dhe vlera e shtuar në Kosovë, nuk kalon vlerën e materialeve të përdorura me origjinë, të cilit do "partneri" tjetër (neni 3 paragrafi 3 i shtojcën I);
- 3) Për produktet të cilat me rastin e eksportit kanë origjinën e vendit "partnerë" dhe janë plotësuar dispozitat paraprake, atëherë është e mundur lëshimi i provës së origjinës (zëvendësimi i certifikatës së origjinës EUR.1, duke pasur në konsideratë që në Rubrikën 4 të certifikatës të vendoset Kodi i vendit "partnerë").

---

## DOKUMENTET QË VËRTETOJNË ORIGJINËN E PRODUKTEVE

---

Produktet origjinuese në një palë kontraktuese gjatë importimit në palë të tjera kontraktuese, do të përfitojnë nga dispozitat e marrëveshjeve përkatëse, me paraqitjen e një prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:


a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në aneksin III a (formë e certifikatës të cilën e kemi përdorur deri me tani në tregtinë me BE, duke u bazuar në Sistemin Autonom të Preferencave EUR.1 000 000);

b) në rastet e specifikuar në nenin 21 (1) një deklaratë që këtu quhet “deklarata e origjinës” të dhënë nga eksportues në një faturë, një notë dërguese apo një dokument tjetër tregtar, ku përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për t’u identifikuar; tekstet e deklaratave të origjinës shfaqen në anekset IV a dhe b.

Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e kësaj Konvente, për sa i takon rasteve të specifikuar në nenin 26, do të përfitojnë nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje, pa qenë e nevojshme të paraqesë ndonjë vërtetim origjine të përmendur më sipër (Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privatë të personat privatë ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari, ose familjarët e tyre, nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojë 500 euro, në rastin e pakove të vogla, ose 1 200 euro, në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtarëve).


MUNDËSIA E KUMULIMIT TË ORIGJINËS NË KONTESTITIN E MSA E NDËRLIDHUR ME MARRËVESHJEN CEFTA

Kumulimi i origjinës – prodhimi i mishit të konservuar




Punim apo përpunim i mjaftueshëm


■ DRURI 4403




Situata para hyrjes në fuqi të MSA-së




Situata pas hyrjes në fuqi të MSA-së



Kumulimi i origjinës MSA




Kumulimi i origjinës MSA



## Kumulimi i origjinës konform MSA

- Vaji I pa Rafinuar i Lulediellit  
1512



**TARIFAT DOGANORE NË MSA PËR PRODUKTET INDUSTRIALE (25-97)**

**Autoveturat e pa regjistruara – të reja**

2015 Volkswagen Golf 2.0 TDI BlueMotion 3-door concept

Vëllimi punues 2000 CCM; Çmimi kushtues **20,000.00 €**

**Kodi në TARIK – 87033219 10**

<b>VITI</b>	<b>2016</b>
<b>Reduktimet tarifë</b>	0
<b>Dogana</b>	0
<b>Akciza</b>	Nuk obligohet për pagesë deri në 2000 cc (nuk paguan akcizë)
<b>TVSH (18%)</b>	3600
<b>TOTAL TAKSA</b>	3600

Analizojmë shembullin e njëjtë të këtij Automjeti por tani kur automjeti është: **1- 8 vite i përdorur.**

Baza doganore e tij është **10,000.00€**

**KODI NË TARIK: 87033290 21**

<b>VITI</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>
<b>Reduktimet tarifë</b>	<b>9%</b>	<b>8%</b>	<b>7%</b>	<b>5%</b>	<b>3%</b>	<b>1%</b>	<b>0</b>
<b>Dogana</b>	900	800	700	500	300	100	0
<b>Akciza</b>	400	400	400	400	400	400	400
<b>TVSH (18%)</b>	2034	2016	1998	1962	1926	1890	1872
<b>TOTAL TAKSA</b>	<b>3334</b>	<b>3218</b>	<b>3098</b>	<b>2862</b>	<b>2626</b>	<b>2390</b>	<b>2272</b>

**TELEVIZORË – KODI NË TARIK 85285100**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË BE-së të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**TELEFONA SMART – KODI NË TARIK 85171200 90**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**LAPTOP – KODI NË TARIK 84713000**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**KOMPJUTERË – KODI NË TARIK 84714900 90**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**MEDIKAMENTE (barna) – KODI NË TARIK 3004**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	0	0	0	0	0

Konform ligjit mbi lirimet doganore (UHËZIMI ADMINISTRATIV (QRK) NR.05-2015 PËR MALLRAT E LIRUARA NGA TATIMI DOGANOR), edhe pse ky mall është i përfshirë në këtë SHTOJÇË.



**PRINTERË – KODI NË TARIK 844331**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET  
INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**BANKOMAT – KODI NË TARIK 847290**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET  
INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**KAMERA – KODI TARIK 852580**

**SHTOJCA Ia** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET  
INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**PARFUMERI - KODI NË TARIK 3303 0010 00**

**SHTOJCA Ib** - KONCESIONET E TARIFAVE TË KOSOVËS PËR PRODHIMET  
INDUSTRIALE TË BE-së, të referuara në nenin 23

VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Red. Tarifore	9%	8%	7%	5%	3%	1%	0

TARIFAT DOGANORE NË MSA PËR PRODUKTET (01-24)

**Shtojca III-a**

■ H.S. 0102



H.S. 0201



■ H.S. 1601



H.S. 2001



H.S. 0713



VITI	2016	2017	2018	2019	2020
Red. Tarifore	8%	6%	4%	2%	0

**Shtojca III-b**

■ H.S. 0407



H.S. 0809



H.S. 0809



■ H.S. 0810



H.S. 1101



H.S. 2009



VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Red. Tarifore	9%	8%	7%	5%	3%	1%	0

**Shtojca III-c**



VITI	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Red. Tarifore	9%	8%	7%	6%	5%	4%	3%	1%	0

**Produktet tërësisht të përfituara – Shtojca III-d**  
**Produktet të cilat nuk liberalizohen (të mbrojtura)**



■ H.S. 0806

H.S. 2204


H.S. 0401



---

KONVENTA REGJIONALE PEM - SISTEMI I KUMULIMIT


---



---

KUMULIMI NË PROCESIN E STABILIZIM ASSOCIIMIT (MSA-KUMULIMI)

---





PUBLIKUAR	VITI	DATA
Dogana e Kosovës	2016	14 prill

*Për informata shtesë ju lutem shkruani në:*

*Email: [msa@dogana-ks.org](mailto:msa@dogana-ks.org) apo*

*Web: <http://dogana.rks-gov.net/sq/msa#msa>*